

**STATUTI**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“ALBERGHI DIFFUSI-KRUJA” SH.P.K.**

**HYRJE**

Sot me date 28/04/2021

Shoqëria “ALBERGHI DIFFUSI-KRUJA” sh.p.k. është themeluar nga ortaku i vetëm.

Themeluesi, në përputhje me ligjin harton edhe statutin e Shoqërisë si më poshtë:

**NENI 1**

**EMRI DHE FORMA**

Emri i kësaj shoqërie është “ALBERGHI DIFFUSI-KRUJA” dhe organizohet e funksionon në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

Shoqëria prezantohet në të gjitha korrespondencat me emrin e shoqërisë dhe shkurtimin që tregon që është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në këtë formë “ALBERGHI DIFFUSI-KRUJA” sh.p.k.”

**NENI 2**

**SELIA**

Selia e shoqërisë “ALBERGHI DIFFUSI-KRUJA” sh.p.k. ndodhet në Krujë, në adresën: Rruga “Kala”, Kati 1, Shtëpi private me nr.pasurie 9/32, zona kadastrale 8621.

**NENI 3**

**OBJEKTI**

1. Shoqëria “ALBERGHI DIFFUSI-KRUJA” sh.p.k. ka për objekt të veprimtarisë së saj kryerjen e çdo veprimtarie të lejuar nga ligji dhe/ose pjesmarrjen në çdo veprimtari apo aktivitete të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar në bazë të legjislacionit shqiptar dhe në veçanti:

- Shërbime në fushën e hotelerisë dhe turizmit.
- Organizim guidash, udhëtimesh dhe paketash turistike, në zonën e Krujës por edhe zona të tjera, brenda dhe jashtë vendit.
- Organizim aktiviteteve dhe eventesh të natyrës turistike, kulturore, argëtuese, shlodhëse, sportive dhe rikrijuese me qëllim promovimin e vlerave dhe atraksioneve turistike të zonës dhe rritjen e numrit të vizitorëve.
- Ofrimi i akomodimit për turistët vendas dhe të huaj.
- Marrja me qira, shfrytëzimi dhe administrimi i objekteve dhe njësisve të shërbimeve akomoduese dhe bar-restorante, me qëllim ofrimin e pijeve, ushqimeve dhe shërbimeve të akomodimit për vizitorët dhe turistët si edhe dhënia me qira/nënqira;
- Organizimi i transportit turistik me guidë shoqëruese dhe marrja me qira e automjeteve.
- Ofrimi i shërbimeve të përkthimit.
- Dinzenjimi dhe organizimi i marketimit të produkteve turistike të zonës.
- Organizimi i trajnimeve për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe tema të tjera që i shërbejnë përmirësimit të ofertës turistike.
- Ofrimi i konsulencës menaxheriale në fushën e turizmit dhe shërbimeve turistike;
- Përgatitja e shpërndarja e materialeve promocionale.
- Prodhimi dhe/ose tregëtimi i suvenireve dhe tregëtim prodhimesh të ndryshme druri, mobilje, orë etj.
- Pjesëmarrja në inisiativa e projekte lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Ndërmjetësimi në fushën imobilare.
- Hapje agjensie turistike, udhëtimesh dhe shitje biletash udhëtimi.
- Transport personash brenda dhe jashtë vendit.

2. Për kryerjen e veprimtarive, për të cilat do të nevojitet leje, shoqëria do të pajiset paraprakisht me lejet përkatëse, të lëshuara nga organet kompetente.

#### **NENI 4**

#### **KOHËZGJATJA**

Shoqëria "ALBERGHI DIFFUSI-KRUJA" sh.p.k. do të zhvillojë aktivitetin që ka për objekt për një periudhë kohore pa afat.

## **NENI 5**

### **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

#### **1. Funksionimi dhe Kompetencat**

Shoqëria "ALBERGHI DIFFUSI-KRUJA" sh.p.k. zotërohet nga një ortak i vetëm dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga Ortaku i Vetëm.

#### **2. Regjistrimi i Vendimeve**

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm do të regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose fshihen.

Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për: miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë, shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve, investime, riorganizimin dhe/ose prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

#### **3. Rregullim i përgjithshëm**

Në rast se shoqëria do të zotërohet nga më shumë se një ortak, të drejtat, detyrimet dhe rregullimet për funksionimin e Asamblesë së Përgjithshme do të jenë ato të përcaktuara nga legjislacioni përkatës.

## **NENI 6**

### **KOMPETENCAT E ORTAKUT TË VETËM**

Për sa kohë Shoqëria "ALBERGHI DIFFUSI-KRUJA" sh.p.k. do të ketë një ortak të vetëm, kompetencat e tij do të jenë:

- Vendos për ndryshimet në Statutin e Shoqërisë dhe përpilon ose miraton rregulloret për Shoqërinë apo për sektorë të veçantë të veprimtarisë;
- Vendos për politikën e përgjithshme të Shoqërisë dhe përcakton fushat konkrete të veprimtarisë së saj;
- Emëron dhe shkarkon administratorin e Shoqërisë dhe detajon kompetencat e tyre të përcaktuara në statut dhe sipas rastit Ekspertin Kontabël;

- Shqyrton bilancin vjetor, përcakton llojin e fondeve të ndryshme dhe masën e tyre, fitimin e realizuar si dhe vendos për marrjen e kredive;
- Vendos për krijimin e degëve ose të përfaqësive si dhe për krijimin e shoqërive me persona të tjerë fizikë apo juridikë, vendas apo të huaj;
- Vendos për mbarimin e Shoqërisë, likuidimin e saj si dhe për shndërrimin e Shoqërisë nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të formave të tjera.

## NENI 7

### ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

#### 1. Emërimi dhe shkarkimi i administratorëve.

Ortaku i vetëm mund të emërojë një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit të tyre është deri në 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje.

Ortaku i vetëm mund të marrë vendim për shkarkimin e administratorit, në çdo kohë.

#### 2. Kompetencat e administratorëve

Pasuria dhe aktiviteti i shoqërisë do të administrohen nga administratori/ët të cilët mund të ushtrojnë çdo kompetencë dhe mund të kryejnë çdo veprim të ligjshëm në emër të shoqërisë, me përjashtim të atyre që legjislacioni dhe statuti ja rezervon Ortakut të Vetëm.

Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen, por pa u kufizuar vetëm në to, të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, të zbatojnë politikat tregtare të vendosura nga Ortaku i Vetëm, të përfaqësojnë shoqërinë, të kujdesen për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël të shoqërisë, të përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë së ecurisë, të kryejnë regjistrime përkatëse në Qendrën Kombëtare të Biznesit, të raportojnë tek Ortaku i vetëm si dhe të kryejnë detyra të tjera që kanë lidhje me veprimtarinë e administratorit siç parashikohet në ligj dhe statut.

Administratorët, me pëlqim të Ortaku të vetëm, kanë të drejtë t'u delegojnë me prokurë një pjesë ose të gjitha kompetencat e tyre personave të tretë kur e konsiderojnë të arsyeshme.

#### 3. Përgjegjësitë

Administratori është individualisht përgjegjës ndaj shoqërisë dhe/ose të tretëve për dëme të shkaktuara si pasojë e shkeljes së rregullimeve të ligjit dhe statutit.

4. Emërimi i administratorit të shoqërisë

Administrator i Shoqërisë“ ALBERGHI DIFFUSI-KRUJA” sh.p.k. , për një afat 5 vjeçar, është emëruar Olsi Pengili.

#### **NENI 8**

#### **KAPITALI SHOQËRISË DHE PJESËMARRJA**

Kapitali themeltar i Shoqërisë“ ALBERGHI DIFFUSI-KRUJA” sh.p.k. është në para, në vlerën 10.000 (dhjetëmijë) Lekë i cili ndahet në 1-kuote me vlerë 10.000 (dhjetemije) Lekë .

Olsi Pengili është Ortak i Vetëm dhe zotëron 1-kuote , që përbën 100% të kapitalit.

Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejta që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet mënyrave të përcaktuara me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

#### **NENI 9**

#### **EKSPERTI KONTABËL I AUTORIZUAR**

Eksperti(et) kontabël i(të) autorizuar do të emërohen me vendim të Ortakut të vetëm, në çdo rast kur një gjë e tillë kërkohet nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë.

#### **NENI 10**

#### **VITI FINANCIAR**

Viti financiar i Shoqërisë“ ALBERGHI DIFFUSI-KRUJA”sh.p.k. fillon më 1 Janar dhe mbaron në 31 Dhjetor të çdo viti.

#### **NENI 11**

#### **DIVIDENTI**

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve, Ortaku i vetëm përcakton pjesën që do të shpërndahet në formën e dividendeve mbi fitimin.

Fitimi që do të ndahet në formë dividendi, përbëhet nga fitimi i vitit financiar të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për fondin rezervë të domosdoshëm dhe nga ana

tjetër i janë zbritur ose i janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

#### **NENI 12**

#### **PRISHJA E SHOQËRISË**

Prishja e Shoqërisë mund të bëhet për arsyet e përmendura në ligj dhe për çfarëdolloj arsyeje që e vështirëson apo bën të pamundur vazhdimin e aktivitetit të saj.

#### **NENI 13**

#### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Statut dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut, do të zbatohen rregullimet e Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe sipas ndryshimeve që ligji mund të ketë në të ardhmen.

Çdo konflikt që mund të lindë në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e këtij Statuti do të zgjidhet nga gjykata kompetente në Republikën e Shqipërisë.

Nëse ndonjë rregullim i këtij Statuti, pas fillimit të zbatimit të tij, do të bëhet objekt diskutimi, ai rregullim duhet të interpretohet duke u bazuar në frymën e përgjithshme të Statutit.

#### **NENI 14**

#### **NËNSHKRIMI**

Ky Statut nënshkruhet sot më datë 28 Prill 2021, nga Ortaku i Vetëm.

#### **ORTAK I VETËM**

**Olsi Pengili**

